



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 223

Ora: 11:00

V E N D I M

M B I

**PËRDORIMIN NË PROCESIN ZGJEDHOR TË DISA MATERIALEVE DHE PËRCAKTIMIN E
KARAKTERISTIKAVE TË PËRGJITHSHME TË TYRE NË PËRDORIM**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Në kuadër të përgatitjeve, të zhvillimit dhe të administrimit të procesit zgjedhor, të përdoren mjetet dhe materialet e përshkruara në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përcaktimi i sasive të mjeteve dhe të materialeve, si dhe i kriterëve dhe specifikimeve teknike të tjera, veçmas atyre që përmban lidhja 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
3. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lidhja 1

Materiali zgjedhor	Perdorueshmeria	Karakteristika të përgjithshme	Karakteristika të veçanta
1.Vulat me Kod sigurie	Shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit dhe të materialeve zgjedhore përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit pas zgjedhor për të garantuar integritetin e fletëve të votimit dhe të dokumentacionit zgjedhor.	1) Vula e sigurisë duhet të jetë rezistente dhe e testuar për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jetë sipas standardeve të zbatueshme. 2) Vula është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse. 3) Vula duhet të jetë e projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht. 4) Çdo përpjekje për të ndërhyrë me anë të ushtrimit të nxehtësisë, forcës mekanike (duke futur një mjet, duke e shpuar, përkulur apo tërhequr) apo kimikateve (tretësve) është e dallueshme nëpërmjet shenjave që lë. 5) Ajo duhet të jetë rezistente ndaj agjenteve atmosferik dhe fizik. 6) Ngjyra përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit	1) Vula e sigurisë do të jetë me qëndrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë/ mos hapjen aksidentale në çfarëdolloj forme të kutive të votimit. 2) Përbërësit e ndryshëm të vulës nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk çngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike. 3) Vula duhet të ketë të shënuar këta elementë: Emri i institucionit: “KQZ”. <ul style="list-style-type: none">• Numri serial i vulës i cili është unik, nga 6 deri në 8 shifra• Barcodi linear / QR code duhet të jetë dhe i qëndrueshëm në trupin e vulës duke siguruar mos fshirjen e tij nëpërmjet fërkimit apo formave të ngjashme 4) Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të

		te punës (ngjyre te veçantë për vulat qe do te përdoren për mbylljen e kutive dhe ngjyre te ndryshme për vulat rezerve).	jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë.
2.Kutia e votimit	Kutia e fletëve të votimit do të përdoret në qendrat e votimit për të mundësuar zgjedhësit të votojnë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në çdo lloj procesi zgjedhor, duke hedhur fletën e votimit në të.	<p>1) Kutia e votimit të jetë e pa palosshme, e hapur vetëm nga një anë, në cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet hedhja e fletës së votimit.</p> <p>2) Të përbehet nga material plastik i tejdukshëm dhe rezistent ndaj goditjeve.</p> <p>3) Kutia duhet te ketë aftësi për te mbajtur ngarkesa te brendshme pa u deformuar.</p> <p>4) Pjesa e sipërme e kutisë (kapaku) te jete i qëndrueshëm ndaj presionit te jashtëm.</p> <p>5) Të mbyllet me kapak i cili lidhet me kutinë me të paktën 4 vula sigurie.</p>	<p>1) Kapaciteti mbajtës (volumi) i kutisë se votimit te jete 85 litra (+/-5 litra) afërsisht e barabartë me kapacitetin e 1.000 flete votimi me përmasa A3) te palosura dhe të jetë me transparencë të lartë për të vëzhguar lehtësisht mos tjetërsueshmërinë votës.</p> <p>2) Forma e kutisë se votimit te jete prizëm gjysmë piramide me lartësi të brendshme 55-60 cm.</p> <p>3) Kapaku i kutive të fletëve të votimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ketë hapësirën e posaçme ku futet fleta e votimit nga zgjedhësi, - të ketë dimensione që përputhen me kutinë e fletëve të votimit, dhe - të mbyllet pa krijuar hapësira me buzët e kutisë. <p>4) Pjesa e hapur e kapakut nëpërmjet të cilës hidhet fleta e votimit të mbyllet të paktën me një vulë</p>

			sigurie në përfundim të procesit të votimit.
3.Kutia e materialeve zgjedhore	Kutia e materialeve zgjedhore do të përdoret në qendrat e votimit nga administrata zgjedhore për të ruaj dokumentacionin zgjedhor dhe materialet e tjera zgjedhore të ripërdorshme.	<p>1) Kutia e votimit të jetë e pa palosshme, e hapur vetëm nga një anë, në cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet vendosja e materialeve/ dokumentacionit zgjedhor.</p> <p>2) Të përbehet nga material plastik i tejdukshëm dhe rezistent ndaj goditjeve.</p> <p>3) Kutia duhet të ketë aftësi për të mbajtur ngarkesa të brendshme pa u deformuar.</p> <p>4) Pjesa e sipërme e kutisë (kapaku) të jete i qëndrueshëm ndaj presionit të jashtëm.</p> <p>5) Të mbyllet me kapak i cili lidhet me kutinë me të paktën 4 vula sigurie.</p>	<p>1) Kutia të ketë në pjesë trupit dhe kapakut të saj jo më pak se 4 vrima, ku të kryhet mbyllja e sigurve e kutisë gjatë procesit të votimit me vula sigurie në të katërta anët e saj.</p> <p>2) Plastika e përdorur për ndërtimin e kutisë të jete transparente, të lartë për të mundësuar vëzhgimin e lehtë për mos tjetërsimin e dokumentacionit zgjedhor.</p> <p>3) Kapaciteti mbajtës i kutisë (volumi) 50-60 litra.</p> <p>4) Lartësia e brendshme: 30-42 cm</p> <p>5) Kapaku i kutive të materialeve të votimit / zgjedhore të jete mbyllur nga sipër dhe të ketë dimensione që përputhen me kutinë e votimit dhe mbyllen pa krijuar hapësira me buzët e kutisë.</p>
4.Bojë timbruese (lëndë e posaçme timbrimi)	Boja përdoret për të timbruar zgjedhësit që votojnë në ditën e zgjedhjeve për të parandaluar votimin e shumëfishtë.	<p>1) Ajo aplikohet në mënyrë tipike në gishtin tregues të dorës së majtë, veçanërisht në shtresën korneum, ku është pothuajse e pamundur të hiqet shpejt.</p>	<p>1) Ngjyra e bojës timbruese duhet të jetë sipas standardeve ndërkombëtare, për të qenë e dallueshme.</p> <p>2) Koha e tharjes të jete me efekt të menjëhershëm nga momenti i aplikimit.</p>

		<p>2) Ajo duhet të ketë jetëgjatësi të punës të paktën një cikël përdorimi 12 muaj nga prodhimi.</p> <p>3) Boja timbruse duhet të jete në formatin e markerit (tush/stilolaps).</p> <p>4) Boja timbruse nuk duhet të hiqet ose të fshihet se paku brenda 24 orëve nga momenti i aplikimit të saj.</p> <p>5) Boja timbruse duhet të jete e pacenueshme nga agjentet atmosferike</p>	<p>3) Boja timbruse duhet të jetë e personalizuar me logon e KQZ-së (versioni i fundit) dhe duhet të ketë të dhëna teknike të gjithë përbërësve të bojës, datën e prodhimit dhe të skadimit për të garantuar shëndetin e zgjedhësve.</p>
<p>5.Dhomat e fshehtësisë</p>	<p>Dhomat e fshehtësisë siguron kryerjen e procesit të shënimit me shënjen përkatëse në fletën e votimit nga zgjedhësi, në mënyrë të fshehtë.</p>	<p>1) Qendrat e votimit do të kenë dhoma të fshehtësisë të ngurta kartoni, plastike ose çdo lloj materiali tjetër të riciklueshëm. Ato mund të jene me konstruksion të ndërlidhur. Dhomat e fshehtësisë kanë edhe një syprinë për të shënuar/ mbajtur fletën e votimit dhe shënimin e zgjedhjes se votuesit.</p> <p>2) Kartoni ose materiali plastik/ i riciklueshëm që do të përdoret për dhomën e fshehtësisë duhet të jete solid dhe i forte kur bashkohen të gjithë pjesët përbërëse të tij për të mos mundësuar rënien aksidentale</p>	<p>Modeli 1</p> <p>1) Lartësia të mundësojë votimin në këmbë nga ana e zgjedhësit, për tu ndjere i pamonitorueshem nga personat e pranishëm në qendrën e votimit dhe nga kamera e monitorimit, për të votuar në mënyrë të fshehte.</p> <p>2) Lartësia nga ana tjetër duhet të marre në konsiderate që fshehtësia e votës të mos mundësojë nga ana tjetër fotografimin e votës nga zgjedhësi.</p> <p>3) Lartësia e syprinës mbajtëses të jete sipas standardeve teknike të projektimit për të mundësuar vendosjen e fletës së votimit në format A2 si dhe</p>

		<p>apo te qëllimshme te pjesëve përbërëse</p> <p>3) Ato vijnë ne dy modele:</p> <p>(Modeli 1) që është modeli i dhomës së plotë dhe (Modeli 2) për për persona me aftësi te kufizuar.</p> <p>4) Materiali te jetë: Rezistent ndaj lagështirës E palosshme</p> <p>5) Në pjesën ballore stampohet stema e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>6) Në pjesën e poshtme stampohet logo e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me barcode / QR code dhe te dhëna te tjera.</p> <p>7) Ne dhomën e fshehtësisë mund te printohen ose te vendosen edhe udhëzime për votuesit.</p>	<p>mundësinë për te lexuar pa asnjë shqetësim.</p> <p>Modeli 2</p> <p>1) Modaliteti i tavolinës. Pra përbehet nga karton/ plastike me palosje te thjeshte (një ose dy palosje). Ajo duhet te mundësojë përdorimin e saj për personat me aftësi te kufizuar ose nga zgjedhësit qe votojnë ulur duke përdorur tavolinat e ambienteve te qendrës se votimit.</p> <p>2) Këto dhoma vendosen ne tavolina qe ndodhen ne qendrën e votimit dhe duhet te mundësojë votimin ne mënyrë te pamonitorueshme dhe te fshehte nga personat e pranishëm ne qendrën e votimit dhe te mos mundësojë nga ana tjetër fotografimin e votës</p> <p>3) Lartësia e mbajtëses te jete sipas standardeve teknike te projektimit për te mundësuar vendosjen e fletës se votimit si dhe mundësinë për te lexuar pa u ndjere i monitoruar.</p>
6. Etiketa e sigurisë	Etiketa e sigurisë shërben për vulosjen/ matrikullimin e materialeve/ambienteve te ndryshme zgjedhore	1) Etiketa e sigurisë duhet të ketë të gjithë elementët e sigurisë për të mbrojtur sendet/ asetet/ ambientet nga çdo	1) Trupi i etiketës duhet te jete i përberë nga material letër plastike (polietilen) me një shtrese dhe i personalizuar me logon

	<p>gjate gjithë proceseve te punës.</p>	<p>ndërhyrje e personave të tjerë. 2) Etiketa e sigurisë është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse. Ajo është projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht. 3) Etiketa të ketë veti gjurmlënëse të dallueshme që lë etiketa ne trupin e saj ose ne sipërfaqen e rrafshët ku do te vendoset.</p>	<p>e KQZ-së dhe të ketë numër serial unik me 6-8 shifra. 2) Trupi i etiketës se sigurisë te bej te mundur etiketimin e te dhënave, si: te përmbajnë fjalën “KQZ” dhe kodin e sigurisë me numër rendor 6-8 shifror. 4) Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë. 5) Gjithashtu trupi i etiketës duhet te ofroje mundësinë e vendosjes te opsionit “Barcode” për aplikacione te lëvizshme.</p>
--	---	---	--